



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË**

Data _____._____.2024

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE KARBURANT PËR MJETET E BASHKISË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KARBURANTE – 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,166,650.83 (katërmbedhjetë milion e njëqinde e gjashtedhjetë e gjahte mije e gjashtëqinde e pesëdhjetë presje tetëdhjetë e tre leke) pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur/fondit limit të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë neëkohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim,

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofrohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
 - b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Operatori

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme/ duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licencë për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel dhe II/A Benzine pa plumb) ose operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licencat/lejet përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante, në përputhje me Ligjin Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje mjedisore të tipit B, lëshuar nga QKL dhe Vërtetim teknik dhe duhet të paraqes Police Sigurimi lëshuar nga shoqërit e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregëtimit me shumicë që vërteton kapacitetet depozituese mbi rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj” dhe Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë paraqesë Flete analiza të lëshuar nga ISHTI e cila duhet të jete e lëshuar brenda 90 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe 6 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që

tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë paraqesë një vërtetim nga ISHTI që subjekti ofertues nuk ka penalitete për shkelje të cilësisë së karburantit për vitin 2023.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Himarë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie,ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesmarrës .Stacionet e tregëtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur liçencë për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel dhe II/A Benzine pa plumb) ose leje tregëtimi në përputhje me dhe në zbatim të Ligjit nr.8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre .”I ndryshuar dhe VKM Nr. 970, date 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.”

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj” dhe Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “ Për lejet e mjedisit”.

Duke qenë se Bashkia Himarë ka një numër të konsiderueshem mjjetesh, do të ishte e nevojshme që subjekti ofertues të ketë minimalisht 2 stacione të tregtimit me pakicë të karburantit. Para vendosjes së këtij kriteri NJHD ka bërë hetim të tregut dhe ka konstatuar se ka disa operatorë që kanë 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Himarë

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar për çdo zë pune.

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Çertifikimet e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer e të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj, të jenë të vlefshme, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh, përveç çertifikimeve të cilat lidhen me procese të veçanta të cilat duhet të plotësohen në përputhje me zërat/proceset e marra përsipër në bashkëpunim

* Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Janë të vlefshme edhe çertifikimet e lëshuara nga organi i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Republika e Shqipërisë, të njohura dhe lëshuara sipas Standardeteve shqiptare të Drejtorisë së përgjithshme të Standardeve.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

ISO 9001:2015

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.

Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.

Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

2.4.2 Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, me tollon ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se mer përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistolette publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se mer përsiper që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit me tollon ose në lëng me bot. Deri në përfundimin e plotë të kontratës sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Karta elektronike duhet të jetë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuara sipas adresave të Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar në VKM nr.561 date 29. 07.2016 “ Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuara me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet autoriteti kontraktor.
- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (ëebpage) që ofron çdo operator ekonomik pjesmarrës përben shkak për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponibilitet te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

Bazuar në VKM nr.561 date 29. 07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet te ofrojnë nje faqe

menaxhimi të karburanteve (webpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.